



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO

Nr. 871 Dt. 06.12.2023
PRISHTINË • PRIŠTINA • PRISTINA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

Prishtinë, 5 dhjetor 2023

Bazuar në Rregulloren për Punën e Komisionit të Arbitrazhit të Federatës së Basketbollit (FBK) të datës 30.08.2023, dhe Propozicionet e Garave të FBK-së të datës 30.08.2023, si dhe në bazë të Ankesës së KB Sigal Prishtina të datës 01.06.2023, Komisioni i Arbitrazhit i FBK-së, me datë 05.12.2023 merr këtë:

V E N D I M

- I. Shpallet e PRANUESHME Ankesa e KB Sigal Prishtina e datës 01.12.2023;
- II. REFUZOHET Ankesa e KB Sigal Prishtina e datës 01.12.2023 si e PATHEMELTË;
- III. MBETET NË FUQI Vendimi i Komisionit të Garave të FBK-së sipas Informatorit Shtesë Nr. 9/2023 i datës 30.11.2023.

A R S Y E T I M

Më datë 04.12.2023, Komisioni i Arbitrazhit i FBK-së, përmes postës elektronike, nga Sekretarja e Përgjithshme e FBK, ka pranuar Ankesën e KB Sigal Prishtina të datës 01.12.2023 (tash e tutje "Ankesa"), e cila ka të bëjë me Vendimin e Komisionit të Garave të FBK-së nga Informatori Shtesë Nr. 9/2023 i datës 30.11.2023, (tash e tutje "Vendimi"), lidhur me incidentin e ndodhur më datë 29.11.2023 në lojën e në mes të KB Sigal Prishtina dhe KB Trepça, që përfshinë edhe lojtarin e KB Trepça, z. Drilon Hajrizi.

Në këtë kuadër, Komisioni i Arbitrazhit i FBK-së ka mbajtur takim më 05.12.2023 dhe ka shqyrtuar Ankesën e KB Sigal Prishtina, si dhe provat e tjera që janë pjesë e dosjes së lëndës, e në veçanti video inqizimin e incidentit në fjalë.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOSARKASKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Biloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

Sipas kuptimit të Komisionit të Arbitrazhit të FBK-së, KB Sigal Prishtina në Ankesë sfidon pikat 6 dhe 7 të Vendimit (Informatorit) që i përkasin këtij klubi dhe që e dënojnë klubin me €1,000 dhe €700 gjobë. Thelbi i Ankesës së KB Sigal Prishtina është se nuk mund të mbahet KB Sigal Prishtina përgjegjëse për veprimet e tifozëve që vijnë si reagim ndaj provokimeve nga lojtari i ekipit tjetër.

Komisioni i Arbitrazhit gjatë trajtimit të lëndës ka shqyrtuar të gjitha dokumentet përkatëse dhe provat në dispozicion, përfshi këtu edhe video inqizimin e incidentit në fjalë, dhe ka konstatuar si në dispozitiv, për arsyet në vijim.

Bazuar ndër të tjera në Nenin 19.15 të Propozicioneve të Garave të FBK-së të datës 30.08.2023, KB Sigal Prishtina, si ekipi vendas ka qenë organizator i ndeshjes në fjalë, dhe përgjegjës për mbarëvajtjen e ndeshjes, përfshi këtu edhe sjelljet e shikueseve dhe të ftuarve të vendosur pranë terrenit. Nga video inqizimi, shihet qartë se në këtë drejtim, KB Sigal Prishtina ka dështuar të përmbushë këtë detyrim, pasi që edhe pas dhënies së vërejtjes nga gjyqtari, gjyqtarët janë detyruar largimin e ekipeve në teshatore si rezultat i hedhjes së gjësendeve në teren nga shikuesit dhe hedhjes/ndezjes së mjeteve piroteknike në parket apo afërsi të tij që ka shkaktuar ndërprerjen e ndeshjes. Përveç asaj, edhe para incidentit në fjalë, ka pasur fyerje në kor të lojtarëve mysafir nga ana e shikueseve, por për të cilat fyerje nuk ka pasur dënim të shqiptuar nga Komisioni i Garave.

Në anën tjetër, pa dyshim që edhe sjellja e lojtarit mysafir z. Drilon Hajrizi nuk ka qenë profesionale, është e papranueshme, dhe len shumë për të dëshiruar. Rrjedhimisht, edhe është dënuar me të drejtë nga Komisioni i Garave në Vendim (Informator), me gjoba prej €100.00 dhe €300.00, bazuar në Nenet 52.1 dhe 52.3 të Propozicioneve të Garave të FBK-së.

Edhe nëse merret si tërësisht i mirëqenë pretendimi i KB Sigal Prishtina, se veprimet e tifozëve kanë ardhur si rezultat i provokimeve nga ana e lojtarit z. Drilon Hajrizi, prapë se prapë, KB Sigal Prishtina nuk mund t'i ikë përgjegjësisë si organizatore e ndeshjes për të siguruar terren të sigurtë për zhvillimin e ndeshjes. Rrjedhimisht, edhe është dënuar me dy gjobat nga Komisioni i Garave në përputhje me Propozicionet e Garave.

Vlen të potencohet se në shqiptimin e gjobave, Komisioni i Garave është thirrë në Nenet 51.12 dhe 51.14 të Propozicioneve të Garave, dhe vlerësimi i Komisionit të Arbitrazhit është se Vendimi i Komisionit të Garave në këto dy dispozita është i qëlluar dhe në përputhje me rrethanat faktike të rastit.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOSARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

Dënimi i lartcekur, në mendim të Komisionit të Arbitrazhit, përqon qartë tek KB Sigal Prishtina, por edhe tek ekipet e tjera, se sigurimi i ambientit të qetë dhe të sigurt nga ekipet vendase është jetik për zhvillimin normal dhe të sigurtë të ndeshjeve, dhe dështimi për të bërë një gjë të tillë ka dhe duhet të ketë pasoja të rrepta.

Rrjedhimisht, Komisioni i Arbitrazhit duke u mbështetur në atë që u tha më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni i Arbitrazhit:

Partin Pruthi
Anëtar

Korab R. Sejdiu
Kryetar

Lulzim Fushtica

Lulzim Fushtica
Anëtar

Prishtinë, 5 dhjetor 2023



Vendimi i dërgohet:

- KB Sigal Prishtina
- Komisionit të Garave të FBK-së
- Anëtarëve të Komisionit të Arbitrazhit
- Arkivit të FBK-së

Këshilla Juridike: Vendimet e Arbitrazhit janë definitive, dhe kundër tyre nuk është e lejuar ankesa brenda FBK-së. Palët e pakënaqura me vendimin e Komisionit të Arbitrazhit kanë të drejtë të ankesës të Këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS) dhe në Gjykatën kompetente përkatëse.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:

